



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

## Evente dhe aktivitete verore 2021

### Raport përmbledhës i sondazhit



Shtator 2021

<i>Grafiku 1. Demografia .....</i>	5
<i>Grafiku 2. A kanë marrë pjesë qytetarët në evente dhe aktivitete .....</i>	5
<i>Grafiku 3. Cilat janë aktivitetet dhe eventet më të pëlqyera .....</i>	6
<i>Grafiku 4. Si vlerësohet organizimi dhe cilësia e eventeve dhe aktiviteteve .....</i>	6
<i>Grafiku 5. A po i bëhet promovim Tiranës nëpërmjet eventeve dhe aktiviteteve .....</i>	7
<i>Grafiku 6. Opinioni nëse është rritur interesi qytetar për jetën artistiko-kulturore.....</i>	7
<i>Grafiku 7. Si ndikojnë eventet dhe aktivitetet në nxitjen dhe mbështetjen ndaj turizmit .....</i>	8
<i>Sugjerimet e hapura.....</i>	8

## Hyrje

Bashkia Tiranë po ofron gjithmonë e më shumë një program të pasur me evente, aktivitete artistike dhe kulturore me karakter lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, një pjesë e të cilave janë kthyer në traditë si p.sh: Tirana Artfest, Tirana Triathlon dhe Maratona, koncerte dhe shfaqje tek Amfiteatri, Panairi i Librit, Festivali Ndërkombëtar i Filmit, Nata e Bardhë si dhe evente të tjera sociale e sportive.

Këto aktivitete kanë patur impakt të madh në jetën artistike e kulturore në Tiranë, dhe janë zhvilluar në vende të ndryshme të kryeqytetit. Sheshi Skendërbej, Sheshi N. Tereza, Sheshi Italia, Amfiteatri tek Parku i Liqenit, Instalacioni Reja, Pazari i Ri si hapësira të shfrytëzueshme, kanë mirëpritur evente kulturore, artistike, sportive etj., ku ka patur një pjesëmarrje të gjerë spektatorësh. Veç këtyre evenimenteve, BT ka organizuar dhe mbështetur shumë aktivitete të tjera të një shkalle më të vogël si shfaqe dokumentarësh, ekspozita artistike, aktivitete sociale dhe natyrore, kulinarie etj.

Nëpërmjet këtyre organizimeve BT synon rritjen e interesit të qytetarëve për të ndjekur dhe për t'u përfshirë në evente dhe aktivitete të shumëllojshme dhe për të gjithë. Duke nisur me fëmijët fare të vegjël të cilët duan të festojnë dhe argëtohen, të rinjtë të cilët kanë nevojë të edukohen dhe socializohen, por edhe të rriturit dhe më të moshuarit mund të ndjekin apo të përfshihen në evente dhe aktivitete të përshtatshme për secilën grupmoshë.

Me një zhvillim të vrullshëm, Tirana është e përshtatshme për vizitorë që tërhiqen nga qytete dinamike, rinore dhe me kontraste kulturore të cilat në kryeqytetin shqiptar bashkëjetojnë në harmoni me njëra-tjetrën. Tirana po përjeton një zhvillim me përmasa të mëdha ndaj mbetet një destinacion që ngjall mjaft interes tek turistët vendas e të huaj. Një prej strategjive të Bashkisë Tiranë për të zgjatur mesataren e qëndrimit të turistëve në kryeqytet gjatë periudhës së verës është pikërisht organizimi i eventeve dhe aktiviteteve kulturore, tradicionale apo festivaleve verore të mirë organizuara të cilat gradualisht po kthehen në traditë të përvitshme.

Një lajm i mirë është dhe shpallja e Tiranës Kryeqyteti European i Rinisë për vitin 2022, një çmim ky dhe një mundësi fantastike për ta kthyer kryeqytetin 365 ditë plot me aktivitete dhe në një pikë takimi për mijëra të rinj nga gjithë vendi, rajoni dhe shumë vende të Europës.

## **Qëllimi dhe objektivat e sondazhit**

Qëllimi i këtij sondazhi është të hulumtojë opinionin qytetar lidhur me eventet dhe aktivitetet artistiko-kulturore e sportive etj. që organizon Bashkia e Tiranës.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah:

- a) Nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në eventet/aktivitetet artistiko-kulturore dhe sportive të organizuara nga BT;
- b) Cilat janë aktivitetet më të frekuentuara dhe të pëlqyera;
- c) Vlerësimin për organizimin dhe cilësinë e këtyre eventeve/aktiviteteve;
- d) Opinionin qytetar për promovimin që po i bëhet qytetit nëpërmjet këtyre organizimeve;
- e) Nëse është rritur interesi i qytetarëve për të frekuentuar aktivitetet dhe eventet;
- f) Ndikimin që kanë zhvillimi i aktiviteteve dhe eventeve në nxitjen dhe mbështetjen ndaj turizmit në kryeqytet;
- g) Sugjerimet e qytetarëve për aktivitetet që dëshirojnë apo mendojnë se mund të zhvillojnë jetën artistiko-kulturore në Tiranë.

## **REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT**


Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së opinionit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:


Të dhëna mbi demografinë (rreth 700 qytetarë të anketuar)

*Grafiku 1. Demografia*


*a. Gjinia*




*b. Grup-mosha (vjeç)*




*Grafiku 2. A kanë marrë pjesë qytetarët në evente dhe aktivitete*



**Grafiku 3. Cilat janë aktivitetet dhe eventet më të pëlqyera<sup>1</sup>**




**Grafiku 4. Si vlerësohet organizimi dhe cilësia e eventeve dhe aktiviteteve<sup>2</sup>**




<sup>1</sup> Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të zgjedhur më shumë se një alternativë brenda pyetjes

<sup>2</sup> Vlerësimi me pikë nga 1 në 10 (1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)


*Grafiku 5. A po i bëhet promovim Tiranës nëpërmjet eventeve dhe aktiviteteve*



*Grafiku 6. Opinioni nëse është rritur interesi qytetar për jetën artistiko-kulturore*



**Grafiku 7. Si ndikojnë eventet dhe aktivitetet në nxitjen dhe mbështetjen ndaj turizmit**



**Sugjerimet e hapura të qytetarëve lidhur me organizimin e aktiviteteve janë kryesisht:**

- aktivitete për fëmijë, të rinj dhe moshat e 3-ta;
- aktivitete për edukimin mjedisor;
- zhvillimi i aktiviteteve jo vetëm në qendër por edhe në zonat e banuara dhe ato periferike;
- aktivitete që promovojnë trashëgiminë kulturore, atraksionet turistike dhe historinë.



# I. ANEKS 1 – PYETËSORI I SONDAZHIT



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

## EVENTE DHE AKTIVITETE VERORE 2021

Nr. i pyetësorit \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

### SEKSIONI I: Demografi

Nj.A./Lagje e qytetarit	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				
	F	M	Nën 18	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

### SEKSIONI II: Pyetje

**P1.** A keni marrë pjesë këtë verë apo keni ndjekur një apo më shumë nga eventet/aktivitetet artistiko-kulturore dhe sportive të organizuara nga Bashkia e Tiranës? (*fan zone, koncerte, festa të ndryshme, aktivitete sportive, Dita pa makina etj.*)

Po  Jo  Pa përgjigje

**P2.** Nëse **Po**, specifiko aktivitetet/eventet që keni marrë pjesë ose keni ndjekur ju dhe/apo familjarët tuaj?

Nr. rend	Aktivitete/Evente	Përzgjidh
1	<b>Tirana Art Fest</b> ( <i>Festival i shkollave të mesme, këngë, kërcim, instrumente etj.</i> )	
2	<b>Fan Zone</b> ( <i>sh. Skënderbe, event sportiv, argëtim, kulinari etj.</i> )	
3	<b>Koncerte dhe festivale</b> ( <i>tek Reja, tek Amfiteatri, tek Liqeni Artificial dhe i Farkës etj.</i> )	
4	<b>Kinema verore</b> ( <i>te Reja, te Amfiteatri, te Pazari i Ri etj.</i> )	
5	<b>Tirana Triathlon</b> ( <i>event sportiv te Liqeni i Farkës</i> )	
6	<b>Ekspozita</b> ( <i>fotografike, pikturë, artizanale etj.</i> )	
7	<b>Dita pa Makina</b> ( <i>aktivitet mjedisor, nxitje për përdorimin e biçikletës</i> )	
8	<b>1 Qershori</b> ( <i>festë për fëmijë, argëtim, muzikë etj.</i> )	
9	<b>Kampi veror për fëmijë</b> ( <i>edukim, argëtim, lojëra etj. te Parku i madh i Liqenit</i> )	
10	<b>Festa e fërgesës</b> ( <i>kulinari te Kalaja e Tiranës</i> )	

**P3.** Në bazë të pjesëmarrjes apo informacionit që keni, cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm për organizimin dhe cilësinë e këtyre eventeve/aktiviteteve që organizon BT? (Vlerëso nga 1 në 10, ku 1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)

Aspak mirë – 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 – Shumë mirë

**P4.** Mendoni se BT po i bën një promovim të mirë qytetit nëpërmjet organizimit të eventeve dhe vëmprimitarive artistiko-kulturore?

Po  Jo  Pjesërisht  Nuk e di

**P5.** Mendoni se është rritur interesi i qytetarëve për të frekuentuar aktivitetet dhe eventet?

Po  Jo  Pjesërisht  Nuk e di

**P6.** Sipas mendimit tuaj, si kanë ndikuar zhvillimi i aktiviteteve dhe eventeve në nxitjen dhe mbështetjen ndaj turizmit në kryeqytet?

Apak mirë  Po mirë  Mesatarisht  Mirë  Shumë mirë  Nuk e di

**P7.** Çfarë aktiviteteve sugjeroni të organizohen nga BT për të zhvilluar edhe më tej jetën artistiko-kulturale në Tiranë?

---

*Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim hulumtimin e opinionit qytetar për eventet dhe aktivitetet artistiko-kulturale e sportive që organizon Bashkia e Tiranës. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".*

*Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.*

## **II. ANEKS 2 – LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR**

1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014.
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"”.